

# *Arsyet e terrenit vetëcensurues për gazetarët*

Ramadan Çipuri<sup>□</sup>

## **Abstrakt**

Vetëcensura përbën një fenomen i cili në mënyra të ndryshme shoqëron jetën profesionale të çdo gazetari. Parë në mënyrën se si ajo ndikon, vetëcensura na shfaqet si diçka “e mirë” dhe “e keqe”. E mirë është kur ndikon në frenimin e pasioneve të individëve që shkojnë në kundërshtim me normat morale e sociale të shoqërisë, por është krejt ndryshe kur ajo kthehet në një sozi të individit e cila e ndjek, duke e vështruar prapa zverkut në tekst, e duke e paralajmëruar që ai të mos bëjë ndonjë gabim ideologjik.

Ky punim do të hedhë dritë mbi arsyet kryesore që çojnë gazetarët drejt vetëcensurimit dhe këto shtrohen në formën e pyetjeve kërkimore: Si vepron censura e vetëcensura te gazetarët?; Cilët janë faktorët që ndikojnë dhe i mbështetin ato?; Cilat janë pasojat e vetëcensurës ndër gazetarë e punonjës të medias?

Për realizimin e këtij studimi do të shfrytëzohen analiza të autorëve të ndryshëm, të mbështetur me fakte konkrete të ndodhura në ndërmarrjet mediatike.

Në fund të studimit do të ketë një qasje konkrete mbi arsyet kryesore që çojnë në vetëcensurimin e gazetarëve.

**Fjalë kyç:** *censurë, vetëcensurë, kontroll politik, pronarë mediesh, reklamëdhënës, propagandë.*

## ***Vështrim mbi vetëcensurën***

Censura e vetëcensura nuk janë gjë tjetër veç dy pjesë të të njëjtin rreth vicioz. Censura prodhon vetëcensurën e të vetëcensurohesh do të thotë që ka një diktat që ushtron presion për censurë. Një përkufizim i tillë i raporteve umbriakale censurë-vetëcensurë do të

---

\* *PhD Cand. Ramadan Çipuri, Universiteti “Hëna e Plotë” (Bedër), Tiranë, Email: rcipuri@beder.edu.al*

na lejojë gjatë këtij punimi shkencor të bëjmë një analizë të thelluar, gjithëpërfshirëse e jo përjashtuese të funksioneve dhe instrumenteve që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë tek individi, grupi, shoqëria e më konkretisht te media si formë komunikimi dhe pushtet mendimi e reagimi.

“Censura e zakonitë përgjithësisht na shfaq dualitet në një proces komunikimi: një autoritet censurues dhe një komunikues i censuruar. Si ka mundësi që në rastet kur censuruesi dhe i censuruari janë i njëjti person, nocioni i censurës gjen kuptim? Ne duhet të supozojmë një dualitet në lidhje me këtë person. Një impuls ose dëshirë e nxit individin drejt të shprehurit diçka, por disa impulse dhe dëshira të tjera kontrollojnë të parat.”<sup>1</sup>

Vlerësimi i vetëcensurës merr kuptime të ndryshme sipas këndvështrimit me të cilin e trajton atë. E përkufizuar në forma të ndryshme e të ngjashme me njëra tjetrën, vetëcensura na shfaqet si një praktikë me të cilin individët shtypin, kufizojnë fjalët dhe veprimet e tyre. E parë në këtë këndvështrim, vetëcensura, por edhe censura kanë qenë subjekt studimesh edhe në fushën e sociologjisë dhe psikologjisë. Profesori i psikologjisë sociale në Universitetin e Standford-it, Dale T. Miller, në librin e tij “Një ftesë për në Psikologjinë sociale” shkruan mbi censurën dhe vetëcensurën. Sipas tij:

Vetëcensura është njëkohësisht e mirë dhe e keqe. Sigurisht që ka akte të vetëcensurës që pasqyrojnë një dështim të vullnetit, por të tjerët ...reflektojnë praninë e fuqisë së vullnetit dhe nxisin guximin mbi dobësinë. Që njerëzit të negociojnë në mënyrë të suksesshme me botën e tyre sociale, ata duhet të kenë aftësinë për të shtypur ndjenjat dhe mendimet e tyre private, dhe, po aq e rëndësishme, të fshehin faktin se ata po bëjnë këtë gjë ... Vetëcensura është gjithashtu thelbësore për funksionimin normal të shoqërisë. Jeta e civilizuar nuk

---

<sup>1</sup> Marlin, Randal. "The Muted Bugle: Self-Censorship and the Press." Në *Interpreting Self-censorship in Canada*, by Klaus Petersen dhe Allan C. Hutchinson, 290-317. Toronto: University of Toronto Press, 1999:291.

do të ishte e mundur nëse njerëzit nuk do të ishin të aftë dhe të gatshëm për të censuruar ndjenjat e forta të tyre antisociale.<sup>2</sup>

Porë në aspektin kuptimor, censura dhe vetëcensura janë dy terma të ndryshëm, por që siç u theksua edhe më lart janë pjesë e së njëjtës monedhë e pjesë e së njëjtit rreth vizioz. "Në censurë, kufijtë e asaj që do të shkruash apo jo vendosen nga aktorë të jashtëm, siç mund të jenë organet shtetërore dhe kompanitë. Nga ana tjetër, te vetëcensurimi, gazetarëve nuk u diktohet hapur se çfarë do të bëjnë e si do të shkruajnë, por ata në një farë mënyre i vendosin kufij vetvetes, duke fshehur fakte që mendojnë se mund të jenë të rrezikshme."<sup>3</sup>

Vetëcensura në ndryshim nga censura është një akt kompromisi i vullnetit të brendshëm të personalitetit krijues, për t'iu përshtatur konteksteve koniukturale të pushteteve, për të qenë gjithmonë "korrekt" me politikën e ditës apo të momentit.

Një ndër shkrimtarët e rëndësishëm të shekullit XX, *Danilo Kish*,<sup>4</sup> (1935-1989), e përkufizon vetëcensurën në këtë mënyrë:

Vetëcensura është leximi i tekstit tënd personal me sytë e huaj, kur ju vetë bëheni i vetëgjykuar, madje i vetëgjykuar më ashpër, se sa ndonjë tjetër, përderisa e dini gjithashtu, edhe atë, të cilën censori asnjëherë nuk do ta zbulojë në tekstin tuaj, pra, atë për të cilën ju keni heshtur dhe të cilën ju kurrë nuk do ta hidhni në letër, por, që juve ju duket se ka mbetur 'ndërmjet rreshtave'. Prandaj censorit të përfytyruar ju i vishni dhe të atilla attribute, që vetë nuk i keni. Kështu sozia juaj ju përndjek mendimet deri në absurd, deri në ekstrem, atje,

---

<sup>2</sup> Dale, T. Miller. "An Invitation To Social Psychology." Publikuar nga Cengage Learning, 2005. (<http://38is.blogspot.com/2012/05/lydia-lim.html>)

<sup>3</sup> Yeşil, Murat. "The Invisible Threat for the Future of Journalism: Self-Censorship and Conflicting Interests in an Increasingly Competitive Media Environment." *International Journal of Business and Social Science*, March 2014: 71-78.

<sup>4</sup> Një ndër shkrimtarët më të rëndësishëm të shekullit XX, poet, prozator, teorian, eseist, autor i vëllimeve poetike "Mansarda"1962; "Psalmi dyzetë e katër" 1962; romanet "Kopshti, hiri" 1972; "Klepsidra"1965; "Po-etika", 1972;"Një varr për Boris Davidiviqin"1978; "Mësimi i anatomisë" 1978; Nata dhe magjia"1983; "Homo poeticus" 1983; "Enciklopedia e të vdekurve" 1983; "Llumi i hidhur i përvojës"1990;

ku gjithçka është e luhatshme, e pasigurt, ndërsa shtegdalje nuk ka: diçka e rrezikshme dhe ndëshkuese ju pret.<sup>5</sup>

Subjekti i vetëcensurës është sozia e shkrimtarit, një sozi, e cila e ndjek, duke e vështruar prapa zverkut në tekst, duke e paralajmëruar që ai të mos bëjë ndonjë gabim ideologjik. Dhe me këtë sozi-censor është e pamundur të lash hesapet. Ai është mu si një Zot gjithëvrojtues e i gjithëdijsëm, sepse është i lindur prej vetë trurit tonë, prej vetë frikërave tona, prej vetë iluzioneve tona, - vijon Kish.

“Vetëcensura shtrihet nga një përkufizim i gjerë, kur vlerësohet si një praktikë e përditshme për çdo gazetar kudo në botë, e shkaktuar nga proceset e pashmangshme të përzgjedhjes dhe seleksionimit në procesin e raportimit dhe redaktimit; në një përkufizim të ngushtë, që përfshin vetëm ato praktika të cilat kryhen për hir të informacioneve të përjashtuara nga përmbajtja e lajmit si pasojë e kërcënimeve të autoriteteve publike”.<sup>6</sup>

Vetëcensura është e vështirë të matet. Si e tillë, ajo vlerësohet në varësi të disa kontrasteve të lehta të treguesve të identifikueshëm si incidente të censurimit zyrtar, burgosje të punonjësve të medieve, përmbajtjet e legjislacionit mbi medien etj, të cilat ndihmojnë për të vendosur pikërisht këtë shkallë krahasimore.

Por, si vepron censura e vetëcensura te gazetarët? Cilët janë faktorët që ndikojnë dhe i mbështesin ato? Cilat janë pasojat e vetëcensurës ndër gazetarë e punonjës të medias? Sipas shkrimtarit të njohur Zija Çela, kryeredaktor në fund të viteve '80 i gazetës “Drita”, gjatë sistemit totalitar, “Në komunizëm shteti botonte, pushteti blinte”<sup>7</sup>

---

<sup>5</sup> Kish, Danilo. a.d. <http://www.litdic.ru/avtocenzura> (vizituar më 11.02. 2015). Përktheu Agron Tufa

<sup>6</sup> Terje S. Skjerdal; *Justifying Self-censorship: A Perspective from Ethiopia; Westminster Papers in Communication and Culture* © 2010 (University of Westminster, London), Vol. 7(2): 98-121. ISSN 1744-6708 (Print); 1744-6716 (Online)

<sup>7</sup> Çela, Zija. “Të gjithë kemi bërë kompromise për të botuar.” *Gazeta Shekulli*, 11.12. 1992.

## Gazetari vetëcensurohet ?

Në literaturën studimore mbi shkencat sociale apo mbi ato të komunikimit, jo rrallë herë rastisen anekdota të cilat përgjithësojnë sjellje të ndryshme sociale. E tillë është historia e treguar me elefantët, të cilët i lidhin për këmbësh me zinxhirë që të mos largohen. Pas një farë kohe, kur janë mësuar me hallkat prej çeliku që nuk i lejojnë të largohen, edhe nëse i liron, ata i gjen aty ku i ke lënë, pasi në kujtesën e tyre kanë regjistruar pengesën prangërore të zinxhirëve.

Vetëcensura mund të vlerësohet si “e mirë” ose “e keqe” në varësi të qasjes që i kushtohet. “Më e keqja shpesh nuk është censura, por vetëcensura”, thotë Bernard Joubert (Bernar Zhubert), autori i *Fjalorit të librave dhe gazetave të ndaluara*, në një intervistë për gazetën franceze, *Nouvel observateur*.<sup>8</sup>

Profesori kanadez i filozofisë në Universitetin Carleton (Çarleton), Randal Marlin (Randëll Marlin), bën klasifikimin e kushteve që çojnë në vetëcensurim. Sipas Marlin, vetëcensura mund të klasifikohet në disa mënyra.

*Së pari*, ai thotë se ekzistojnë motive të ndryshme. Një motiv shumë i përbashkët është ai ekonomik, i cili varion nga mbijetesa e gazetës ose revistës deri te qëllimi që thjesht të përfitojë më shumë nga të ardhurat. Motive të tjera mund të jenë politike, dëshira për të ruajtur jetën, shëndetin dhe punën e dikujt.

*Së dyti*, - thotë Marlin, - ekzistojnë nivele të ndryshme të realizimit të censurës. Disa raste janë thjesht personale, të njohura vetëm nga censuruesi. Të tjera mund të jenë institucionale, për shembull, kur një autoritet më i lartë urdhëron mospublikimin e një materiali të miratuar në nivele më të ulëta.

Studiuesi kanadez, në një *shkallë të tretë* klasifikimi përcakton faktin se vetëcensura mund të mendohet në termat e formës që merr. Për shembull, Për t’iu përshtatur njëanshmërisë së vendit ku punon, një

---

<sup>8</sup> Joubert, Bernard. *L'OBS*. 23 01 2013. <http://tempsreel.nouvelobs.com/vu-sur-le-web> (vizituar më 11. 02. 2015).

shkrues mund të paraqesë termin “regjim” në vend të fjalës “qeveri”, edhe pse kjo është kundër parimeve të tij gazetareske.<sup>9</sup>

“Së katërti, autocensura mund të shikohet në aspektin e presioneve të ndryshme që mund të ushtrohen. Një kategori mund të jetë kur ekziston censura formale, sepse vetëcensura synon të jetë në gjysmëhije, përtej kufijve zyrtarë të ndalimit të shprehjes.”(Marlin 1999).

Autorë të ndryshëm paraqesin arsye të ndryshme që nxisin vetëcensurën.

“Ajo që është më shqetësuese në censurën e ushtruar, është se censura në shumë raste është vullnetare”, shkruan Xhorxh Oruell në parathënien e librit *Ferma e kafshëve*: “Kushdo ka jetuar disa kohë në një vend të huaj, mund të konstatojë se disa informacione, që duhet të kishin hapur me tituj të mëdhenj faqet e gazetave, injoroheshin nga media britanike, e, kjo, jo si rezultat i ndonjë ndërhyrjeje nga qeveria, por se duket që kishte një marrëveshje të heshtur për të mos ‘botuar fakte të tilla’.”<sup>10</sup>

Ndërkohë, Edward S. Herman (Eduard S. Herman) dhe Noam Chomsky (Noam Çomski) rendisin pesë lloje të ndryshme filtrash, të cilat veprojnë mbi mjetet e komunikimit masiv dhe që nxisin fenomenin në fjalë. Këto janë:

1. Struktura dhe orientimi i biznesit, pra, pronësia dhe përfitimi
2. Reklama, ku masmedia mbështetet në të shumtën e rasteve
3. Mbështetja në informacionin e dhënë nga qeveria, biznesi apo ekspertët që financohen nga burimet e parapërmendura
4. Kritika e ashpër në kuadër të disiplinimit të medias
5. “Antikomunizmi” si diçka e ngjashme me një fe shtetërore dhe që vepron si një mekanizëm kontrollues<sup>11</sup>

---

<sup>9</sup>Marlin, Randal. "The Muted Bugle: Self-Censorship and the Press." Në *Interpreting Self-censorship in Canada*, by Klaus Petersen dhe Allan C. Hutchinson, 290-317. Toronto: University of Toronto Press, 1999.

<sup>10</sup>Orwell, George. *Ferma e kafshëve*. Tiranë: Onufri, 2006.

<sup>11</sup>Herman, Edward S., and Noam Chomsky. *Manufacturing consent: the political economy of the mass media*, 1-35. New York: Pantheon Books, 1988.

## Frika si akt vetëmbrojtjeje

Frika si akt vetëmbrojtjeje besohet të jetë një arsye thelbësore për vetëcensurim. “Parë në këtë këndvështrim, vetëcensura ndodh kur gazetari dhe media nuk drejtohen nga shqetësimet editoriale, por nga frika”.<sup>12</sup> “Frika e humbjes së vendit të punës apo rreziku i jetës është një arsye për shumë gazetarë që të mos zgjedhin për të shkruar çdo gjë të cilën ata kanë gjetur jashtë dhe që i detyron të fshehin faktet të cilat kanë zbuluar si rezultat i kërkimit të tyre. Pikërisht ky akt përbën atë që ne quajmë vetëcensurim”.<sup>13</sup>

Kushtet e punësimit të gazetarëve janë një tjetër çështje që ka të bëjë me cilësinë e produktit informacion. Sipas një anketimi të vitit 2012, raportohet se vetëm 42 përqind e gazetarëve të anketuar kishin kontratë të rregullt gjatë gjithë periudhës së punësimit, 26 përqind kishin një kontratë për një pjesë kësaj periudhe punësimi, ndërsa 32 përqind e tyre nuk kishin fare.<sup>14</sup> Në raportin e vitit 2013, UGSH raportonte se “në gjashtë muajt e fundit, pagat e gazetarëve ishin vonuar në 75 përqind të medieve në vend për një periudhë dy deri në gjashtë muaj. Në këtë periudhë, gazetarët kishin hapur 48 padi për pushim të pajustificuar ose për mosrespektim të Kodit të Punës”.<sup>15</sup> Shqetësimi erdhi sërish në vitin 2015 kur kryetari i UGSH-së Aleksandër Çipa theksoi mungesën e pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore të qindra gazetarëve që nga viti 1990 dhe deri më sot.”<sup>16</sup>

---

<sup>12</sup>White, Aidan. *Ethical Journalism Network*. a.d. <http://ethicaljournalismnetwork.org/en/contents/fear-in-the-news-the-difference-between-self-censorship-and-ethical-journalism> (Vizituar më 12. 02. 2015).

<sup>13</sup> Yeşil, Murat. “The Invisible Threat for the Future of Journalism: Self-Censorship and Conflicting Interests in an Increasingly Competitive Media Environment.” *International Journal of Business and Social Science*, March 2014: 71-78.

<sup>14</sup> UGSH. *Praktikat e punës informale në median shqiptare*. Vjetor, Tiranë: Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, 2012: 38.

<sup>15</sup> UGSH. *Deklaratë e Unionit të Gazetarëve Shqiptarë*. Tiranë. 21 Shtator 2013.

<sup>16</sup> Çipa, Aleksandër. *Deklaratë për shtyp*. Dita e miqësisë, Durrës. 24 Shkurt 2015.

“Nëse nuk gjejmë kurajën për të kapërcyer frikën, vetëcensura do të përhapet, dhe jo vetëm në media.”<sup>17</sup>, shkruan prestigjiozja britanike *The Guardian* menjëherë pas sulmeve terroriste në redaksinë e revistës satirike *Charlie Hebdo* në Paris më 7 janar 2015.

### Propaganda si burim vetëcensure

Jacques Ellul (Zhak Elul) vlerëson masmedian si një ndër instrumentet e rëndësishme për ekzistencën e propagandës. “Propaganda nënkupton një propagandues dhe disa të propagandueshëm; propaganduesi është ai që di; të propagandueshmit janë ata që nuk dinë, budallenjtë, siç thotë Simiandi (Simiandi). Ai që di u mëson atyre që nuk dinë.”<sup>18</sup>

“Për të mundësuar organizimin e propagandës duhet që të ketë një media të përqendruar. Ndikimi do të jetë akoma më i madh, nëse medie të ndryshme përqendrohen në të njëjtën dorë.”<sup>19</sup> Në rastet kur individët janë të lidhur pas një medie të caktuar, qoftë kjo gazetë, radio, televizion a ndonjë tjetër, rritet mundësia e rënies pre ndaj propagandës.

Në lidhje me mënyrën se si mediumi ndikon në masa, sociologu kanadez Marshall McLuhan (Marshall MekLuhan) vlerëson se i njëjti mesazh mund të ketë efekte krejt të ndryshme, varësisht medies që e transmeton. MekLuhani thekson: “Mediumi është mesazhi. Ajo që ka rëndësi nuk është përmbajtja e mesazhit, por mënyra se si ky mesazh transmetohet.”<sup>20</sup>

---

<sup>17</sup> Cohen, Nick. *The Guardian*. 11 Janar 2015. <http://www.theguardian.com/commentisfree/2015/jan/11/paris-attacks-we-must-overcome-fear-or-self-censorship-will-spread> (Vizituar më 14 Shkurt, 2015).

<sup>18</sup> Balle, Francis. *Mediat & shoqëritë*. Tiranë: Papyrus, 2011: 743.

<sup>19</sup> Ellul, Jacques. *Propaganda; The Formation of Mens's Attitudes*. New York: Random House of Canada Limited, 1973:102.

<sup>20</sup> McLuhan, Marshall. *Understanding Media: The Extensions of Man*. New York: McGraw-Hill, 1964:2.

### **Kufizimet paraprake**

Këta janë format më të hapura dhe më të dëmshme të censurës që shkaktojnë vetëcensurën. Organet shtetërore përmes sistemit që vendosin kërkojnë kontrollin paraprak të çdo materiali të paracaktuar për publikim apo transmetim. Më pas vendoset formalisht nga censuruesit nëse ky material do të shpërndahej apo jo.<sup>21</sup>

Ky lloj kufizimi vihet re kryesisht në regjimet totalitare. Në Shqipëri, kufizimi paraprak shoqëroi të gjithë historinë komuniste nga viti 1945 deri në vitin 1991. Madje, në *Kushtetutën e vitit 1976*, ky kufizim u përforcua edhe më shumë me nenin famëkeq 55 mbi "Agjitacionin dhe propagandën kundër shtetit"<sup>22</sup>

Kufizimet paraprake vihen re gjerësisht edhe në raportimet në kohë lufte. Gjykata Supreme Amerikane sugjeron se censura mbi mediet në kohë lufte mund të lejohet në disa raste, e konkretisht në katër të tillë. Ato janë: (1) mohimi i hyrjes në hapësira vendore, lokalitete; (2) mohimi i qasjes në dokumente dhe fotografi; (3) dënimi për publikimin e informatave të sigurisë kombëtare; (4) vetëcensura nga mediet informative.<sup>23</sup>

### **Kontrolli politik mbi medien si shtysë vetëcensure**

Format e mundshme të kësaj censure kryesisht si burim i kontrollit të politikës ndaj medieve janë disa. Peter T. Lesson (Petër T. Leson) dhe Christopher J. Coyne (Kristofer J. Kojn), studiues amerikanë të komunikimit, parashtrojnë katër faktorët e mëposhtëm si ndër kryesorët, që ndikojnë në manipulimin e medieve:

- a. Kontrolli direkt përmes pronësisë
- b. Kontrolli indirekt përmes infrastrukturës
- c. Kontrolli indirekt përmes presionit financiar

---

<sup>21</sup> Sturges, Paul. a.d. <http://www.ifla.org/files/assets/faife/publications/sturges/self-censorship.pdf> (qasja Janar 04, 2015).

<sup>22</sup> Kushtetuta. "LIGJ Nr.5506, datë 28.12.1976, Neni 55." Tiranë, 28 Dhjetor 1976.

<sup>23</sup> Chapter 3, The First Amendment, contemporary problems, f.87  
a.d.file:///C:/Users/university%20beder/Downloads/Pember17\_Ch03%20(1).pdf (Vizituar më 13 Janar, 2015).

d. Kontrolli indirekt përmes rregullimit ligjor<sup>24</sup>

*Kontrolli direkt përmes pronësisë* ndodh në rastet kur media zotërohet tërësisht nga shteti dhe nuk është e vështirë të imagjinohet se si qeveria mund të influencojë mbi rrjedhën e informacionit. Këto ndërmarrje mediatike financohen tërësisht nga shteti, rrjedhimisht nuk kanë varësi nga aksionarë privatë. Në rastin e medieve publike, nuk është e vështirë që të kuptohet influencimi i qeverisë mbi produktin mediatik. Edhe sot e kësaj dite, ligji shqiptar parashikon organet drejtuese të institucioneve që monitorojnë funksionimin e sektorit mediatik, si të zgjedhur me pëlqimin e shumicës parlamentare.

*Kontrolli indirekt përmes infrastrukturës, apo mjeteve që mundësojnë produksionin mediatik.* Nëse organet e medias janë në pronësi private, por mjetet jetike të prodhimit dhe shpërndarjes janë monopolizuar në duart e shtetit, kontrolli i qeverisë mbi mediet mbetet sërish i fortë. Këto mjete në dorë të shtetit mund të jenë të ndryshme, si: monopoli shtetëror mbi shtypshkronjat, shpërndarjen e gazetave etj.

*Kontrolli indirekt përmes presionit financiar* është një tjetër mënyrë censure mbi ndërmarrjet mediatike dhe që nxit vetëcensurën tek punonjësit e medieve. Përveç atyre publike, ka edhe shumë medie private të cilat i rezistojnë konkurrencës së tregut vetëm duke u besuar të ardhurave prej reklamave nga buxheti shtetëror.

*Kontrolli indirekt përmes rregullimeve ligjore.* Duke patur në dorë instrumenta të ndryshëm për lejimin ose jo të hyrjes në treg të ndërmarrjeve mediatike, qeveria mund t'ua ofrojë këtë mundësi ose jo atyre që janë kritikë ndaj saj. Në këtë mënyrë, rregullat e vendosura prej organeve shtetërore përbëjnë një metodë kontrolli. Rregullat që pushteti vendos për çeljen ose të jo të këtyre medieve ndikojnë drejtpërdrejt në kontrollin dhe manipulimin e medias.

### **Veprimet me pasoja juridike**

Kjo mënyrë lë një hapësirë për gjykim të hapur ndaj personit në veprim, si edhe një mundësi debati mbi çështjen në fjalë. Ajo i lejon

---

<sup>24</sup> Leeson, Peter T., dhe Christopher J. Coyne. "Manipulating the Media" *Institutions and Economic Development* 1, nr. 2 (Nëntor 2011).

gjithkujt, i cili ka një informacion e dëshiron ta bëjë atë publik, që të mendohet mirë për pasojat me të cilat mund të përballet. Por ideja se rasti i dikujt mund të përballet me një padi apo vendim gjykate, nuk e pengon detyrimisht individin të sillet sipas asaj që dëshiron. Ai mund ta publikojë informacionin që ka dhe të pranojë përballjen me drejtësinë sipas parashikimeve legjislative.

Për shembull, në rast se një gazetar me informacionin që publikon fyen, shpif apo kryen vepra të ngjashme ndaj një personi tjetër, me kërkesë të të dëmtuarit çështja trajtohet nga gjykatat respektive. Në mbështetje të palës së dëmtuar, Kodi Penal në nenet 119, 120, 121, 122 dhe 123 parashikon një sërë masash ndaj të paditurit.

### **Pronësia mediatike**

Në modelin sipas të cilit mediet funksionojnë sot, raportet e pronarëve të medieve me punonjësit mediatikë, përfshirë këtu aktorët që mundësojnë çdo prodhim të medias, mund të analizohen në dy këndvështrime. Së pari, sipas logjikës së ekonomisë së tregut ku ndërmarrjet synojnë përfitime financiare maksimale në një kohë të shkurtër, dhe, së dyti, sipas raporteve që pronarët mediatikë ndërtojnë me përfaqësuesit e politikës, e sidomos me ata që janë në pushtet, si edhe me grupe të caktuara interesi.

Një formë e vetëcensurës institucionale na shfaqet te mbrojtja e interesave të pronarit nga përmbajtja e publikuar. “Në thelb pronarët, në mënyrë të ngjashme si politikanët, në stacionet publike veprojnë nëpërmjet politikës së personelit: Kush emëron dhe urdhëron kryeredaktorët, kontrollon edhe tendencat e përmbajtjeve.” (Stephan Russ Mohl: 283)

Kur flet për raportet midis gazetarëve dhe drejtuesve, drejtori i Informacionit në *ABC News*, Armand Shkullaku, thotë se nuk ka debate profesionale për ide, tema që duhen ndjekur, për investigime etj, por thjesht kontrolli profesional i një redaksie kthehet në një kontroll për të qenë në rregull me pronarët.<sup>25</sup>

---

<sup>25</sup> Shkullaku, Armand. “Karakteristikat e menaxhimit redaksional në Shqipëri dhe Kosovë.” Në *Media në demokratizim*, nga Grup autorësh, 180-184. Tiranë:

### **Kufizimet e konformizmit**

Këto kufizime kanë të bëjnë me kujdesin e treguar ndaj frikës së të shkuarit ndesh me parimet e pritshmërive sociale. Kufizimet e ardhura prej konformizmit i kalojnë caqet e kufijve personalë. Ata kthehen në mjete mbështetëse të censurës dhe e forcojnë ndikimin e saj. Kjo është më e dukshme në grupe të mbyllura e komunitete të vogla, që mund të jenë përfaqësi etnike, fetare etj. “Shkenca gjithashtu tregon modele të qarta të vetëcensurës. Kohët e fundit një grup redaktorësh nga revista të ndryshme shkencore u kërkuan shkencëtarëve që të jenë të kujdesshëm në publikimin e hulumtimeve me zbulime të rëndësishme bio-kimike, si mundësi shfrytëzimi të tyre prej terroristëve në akte të mundshme terrori.”<sup>26</sup>

### **Raportet e medieve me reklamuesit**

“Ndikimi i reklamuesve vihet re më shumë në momente krizash ekonomike, kur krijohet një varësi strukturore e medieve nga ekonomia e reklamës, pasi kush nuk siguron një mjedis për reklamë dhe objekt-grupet që premtojnë biznes të mirë, mbetet mbrapa në tregun e reklamave.” (Russ-Mohl 2010,284)

Thithja e reklamave është një ndër synimet parësore të pronarëve të medieve. Parë në këtë këndvështrim, raporti midis medieve dhe reklamuesve na paraqitet në dy drejtime; së pari, ideimi i programeve apo rubrikave të tilla që tërheqin sa më shumë reklamë. Së dyti, lidhja me reklamë-dhënësit kthehet në një marrëdhënie varësie ndaj njëritjetrit, pra, mediet i druhen dhënies së informacionit, që bie ndesh me interesat e palës tjetër.

“Ndodh që vetë bizneset mund të padisin një media të caktuar në lidhje me publikimin e punës investigative të gazetarëve e cila mund të rëndojë mbi interesat tyre. Ana tjetër e medaljes mund të jetë edhe

---

Papirus, Fondacioni Konrad Adenauer, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, 2015.

<sup>26</sup> Sturges, Paul. a.d. <http://www.ifla.org/files/assets/faife/publications/sturges/self-censorship.pdf> (vizituar më 04 Janar, 2015).

kërcënimi për tërheqjen e reklamave. Këtu nis edhe dilema e vetëcensurimit të drejtorëve, kryeredaktorëve të informacionit apo edhe vetë gazetarëve.”<sup>27</sup>

Marlini thotë për këtë fenomen: “Kur gazetat janë të sunduara nga reklamat, është e vështirë të besohet se përmbajtja redaktoriale do të jetë plotësisht e sinqertë.”<sup>28</sup>

Sipas Çomskit dhe Hermanit “... fuqia e reklamuesit mbi shumë programe televizive buron nga fakti i thjeshtë se ata blejnë dhe paguajnë për programet, ata janë ‘klientët’ të cilët subvencionojnë mediet.”<sup>29</sup>

### **Presionet e grupimeve fetare dhe etnike**

Në një editorial të titulluar *Përse i publikova ato karikatura*, Flemming Rose (Fleming Rous), redaktori i kulturës në të gazetën daneze *Jyllands-Posten*, shpjegon arsyet prej gazetari se përse më 30 shtator 2005 kishte vendosur të publikonte karikaturat e Profetit Muhamed. Arsyeja kryesore që Rousi flet është rritja e ndjeshme e shkallës së vetëcensurimit ndër gazetarë e artistë në lidhje me përmbajtjet e publikuara mbi elementët e besimit Islam. Rousi argumenton se përpjekja për të ndërmarrë një hap kundër cenimit të fjalës së lirë dhe vetëcensurimit të gazetarëve justifikon atë që ndodhi.<sup>30</sup> Është pikërisht kjo mënyrë mendimi dhe veprimi, e cila nxit edhe frikën ndër gazetarë për mënyrat se si duhet të raportojnë. Janë këto përplasje ku me karakter etnik e ku me karakter fetar të cilat i shtyjnë gazetarët të vetëcensurohen.

---

<sup>27</sup>Johnson, Nicholas. *Global Issues, media and ethics* (Department State) 6, nr. 1 (2001): 6-9.

<sup>28</sup>Marlin, Randal. "The Muted Bugle: Self-Censorship and the Press." Në *Interpreting Self-censorship in Canada*, nga Klaus Petersen dhe Allan C. Hutchinson, 305. Toronto: University of Toronto Press, 1999.

<sup>29</sup>Herman, Edward S., dhe Noam Chomsky. *Manufacturing consent: The political economy of the mass media*, . New York: Pantheon Books, 1988: 16

<sup>30</sup>Rose, Flemming. *Washington Post*. 19 Shkurt 2006. <http://www.washingtonpost.com/wp-dyn/content/article/2006/02/17/AR2006021702499.html> (Vizituar më 20 Janar, 2015).

### **Burimet e informacionit**

“Në qoftë se gazetarët do të mbeteshin kryesisht mbi informacionet zyrtare, ata do të ktheheshin në gramafona zyrtarë, ndërkohë që ky koncept i lirisë së shtypit do të kishte shumë pak të bënte me të drejtën e qytetarit që të informohet.”<sup>31</sup> “Shpesh, materialet me ndjeshmëri të lartë vijnë nga burime, të cilat duhet të mbeten anonime, në mënyrë që të mbrojnë veten e tyre.”<sup>32</sup> Por, burimet e informacionit, përtej rëndësisë që kanë për gazetarin dhe sigurimin e të dhënave, ndodh që të kthehen në një faktor presioni mbi punonjësit e medias.

Nga ana tjetër, ka nga ata që mendojnë se burimet e shumta të informacionit mund të shkaktojnë varësi dhe probleme në raportim. Sipas Kovaçit dhe Rosenstielit, përdorimi i burimit anonim për materialet faktike, që mund të konfirmohen, është shumë më i vlerësueshëm sesa të përdorësh burime anonime, të cilat shprehin mendimin e tyre.<sup>33</sup>

### **Etika dhe politikat publike si mjet vetëcensure**

Janë të rrallë ata eticienë të cilët do të thoshin se të gënjerit apo terma të ngjashme me këto sjellje që konsiderohen si negative janë veprime të cilat asnjëherë nuk mund të justifikohen moralisht.

Në lidhje me ndikimin e etikës dhe politikave publike në vetëcensurë, Randal Marlini thotë se motivet për t’u justifikuar ekzistojnë në disa raste. E tillë mund të jetë dëshira për të reduktuar dhunën etnike, me mos publikimin e së cilës gazetarët dhe redaktorët i paraprijnë ndezjes së një atmosfere të dhunshme në publik. Por, - thotë Marlin, - edhe nëse është kështu, ekzistojnë argumente të forta që fakte të tilla duhet të raportohen.

---

<sup>31</sup> Wilhelm, Patricia. “Mbrojtja e burimeve të informacionit. Media: Rrugët drejt lirisë.” Në *Diskutim për etikën*, nga ISHM, 147-152. Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2007.

<sup>32</sup>Kovach, Bill, dhe Tom Rosenstiel. *Si të njohësh të vërtetën në epokën e mbingarkesës së infomacionit*. Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2014:83.

<sup>33</sup>Kovach dhe Rosenstiel: 84

Marlini vlerëson se ka shumë të dhëna që vërtetojnë se kur shpërndarësit e lajmeve nuk besohen, njerëzit mbështeten për të marrë informacion tek burime alternative, të paskrupullta, përfshirë rrjete tradicionale thashethemesh dhe propaganduese. Gjithashtu, me ekzistencën e mjeteve të reja të komunikimit, si : faksi dhe interneti, vetëcensura nuk ka gjasa të funksionojë.<sup>34</sup>

Por çfarë e legjitimon fshehjen e së vërtetës? A duhen menduar pasojat e mundshme sociale të botimit të materialeve të tmerrshme e të tepruara? Po ato që kanë të bëjnë me shkëlqjen e dinjitetit të individëve dhe që tërheqin vëmendjen e publikut?

Politika e përcëmimit të pyetjeve të tilla bazuar në këndvështrimin se industria e informacionit do të përfshihet në vlerësimet morale, duke u shndërruar kështu në një qasje elitiste, nuk duket e drejtë gjithashtu. Sipas studiuesit Marlin, ajo çka duhet parë me kujdes është nëse kriteret për vetëcensurën janë aplikuar në mënyrë objektive dhe jo përzgjedhëse në dëm të një grupi apo grupeve të pafavorizuara.

Për këtë situatë mund të jetë shfajësim mbulimi i së vërtetës në rastet kur kemi të bëjmë me stereotipizim të grupeve të caktuara etnike, fetare e të ngjashme me ta. Për të mos kaluar në ekstreme të tjera, kjo përpjekje për të mbuluar të vërtetën e për të luftuar stereotipet e rreme mund të jetë e pranueshme deri në pikën e mostheksimit të fakteve që mbështesin shtrembërimin ekzistues, por kurrsesi jo në favor të falsifikimit të realitetit.

E rëndësishme për gazetarët, redaktorët dhe botuesit është që të jenë vigjilentë ndaj presioneve të larmishme që i largojnë nga misioni qendror i tyre dhe të kryejnë një punë të ndershme në informimin e publikut, pavarësisht këtyre presioneve, qofshin këto edhe të motivuara nga forma të ndryshme sociale.

## ***Përfundime***

Ky punim, fillimisht është përqendruar kryesisht mbi përkufizimin e *vetëcensurës*, porë kjo në këndvështrimin e autorëve të ndryshëm, studiues të njohur të fushës.

---

<sup>34</sup>Po aty

Ajo që duhet të qartësohet që në fillim është se *vetëcensura*, ndryshe nga *censura*, është një fenomen që nuk mund të matet në një mënyrë të saktë. Edhe në qoftë se është rënë dakord që ky lloj i censurës është një karakteristikë kyçe e mjediseve shtypëse të medias, grupet dhe organizatat e lirisë së shtypit përballen me sfidën se si do ta përcaktojnë nivelin e vetëcensurës, mbi ç`baza dhe indikatorë specifikë, në mënyrë që të mund të bëjnë edhe dallimin midis vendeve dhe sipërmarrjeve të ndryshme mediatike.

Çfarë vihet re qartazi është se shkaqet që çojnë në vetëcensurimin e gazetarëve janë të ngjashme, përtej nivelit të demokracisë në të cilën mediet respektive operojnë.

Pavarësisht instrumenteve të përdorur për të kontrolluar, dëshira e pushtetit për të pasur ndikimin mbi mediet mbetet pothuajse e njëjtë, si në demokracitë e zhvilluara, po ashtu edhe në ato në zhvillim, e pse jo edhe në ato totalitare.

Presionet e pronarëve mediatikë, lidhjet e tyre me agjencitë shtetërore e me reklamdhënësit mbeten sërish burime të rëndësishme për vetëcensurimin e gazetarëve kudo qofshin ata.

Kushtet në të cilat gazetarët punojnë, pasiguria e tyre dhe frika për humbjen e vendit të punës përbëjnë një tjetër element vetëcensurues për gazetarët, të cilët detyrohen të jenë pjesë e propagandës që përhap institucioni mediatik ku ata bëjnë pjesë.

## ***Bibliografia***

Balle, Francis. *Mediat & shoqëritë*. Tiranë: Papyrus, 2011.

Çela, Zija. «Të gjithë kemi bërë kompromise për të botua.» *Gazeta Shekulli*, 12 11 1992.

Çipa, Aleksandër. *Deklaratë për shtyp*. Dita e miqësisë, Durrës. 24 Shkurt 2015.

Cohen, Nick. *The Guardian*. 11 Janar 2015. <http://www.theguardian.com/commentisfree/2015/jan/11/paris-attacks-we-must-overcome-fear-or-selfcensorship-will-spread> (vizituar më 14 Shkurt, 2015).

Dale, T. Miller. «An Invitation To Social Psychology.» Publikuar nga Cengage Learning, 2005.

Ellul, Jacques. *Propaganda; The Formation of Mens` Attitudes*. New York: Random House of Canada Limited, 1973.

file:///C:/Users/university%20beder/Downloads/Pember17\_Ch03%20(1).pdf (vizituar më 13 Janar, 2015).

Herman, Edward S., dhe Noam Chomsky. *Manufacturing consent: the political economy of the mass media*. New York: Pantheon Books, 1988.

Johnson, Nicholas. *Global Issues, media and ethics* (Department State) 6, nr. 1 (2001): 6-9.

Joubert, Bernard. *L'OBS*. 23 01 2013. <http://tempsreel.nouvelobs.com/vu-sur-le-web> (vizituar më 11 02, 2015).

Kish, Danilo. a.d. <http://www.litdic.ru/avtocenzura> (vizituar më 11.02.2015).

Kovach, Bill, dhe Tom Rosenstiel. *Si të njohësh të vërtetën në epokën e mbingarkesës së informacionit*. Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2014.

Kushtetuta. «LIGJ Nr.5506, datë 28.12.1976, Neni 55.» Tiranë, 28 Dhjetor 1976.

Leeson, Peter T., dhe Christopher J. Coyne. «Manipulating the Medi.» *Institutions and Economic Development* 1, nr. 2 (Nëntor 2011).

Marlin, Randal. "The Muted Bugle: Self-Censorship and the Press." In *Interpreting Self-censorship in Canada*, by Klaus Petersen and Allan C. Hutchinson. Toronto: University of Toronto Press, 1999. (290-317)

McLuhan, Marshall. *Understanding Media: The Extensions of Man*. New York: McGraw-Hill, 1964.

Orwell, George. *Ferma e kafshëve*. Tiranë: Onufri, 2006.

Rose, Flemming. «Përse i botova karikaturat.» Në *Diskutim për etikën*, nga ISHM, 2017-220. Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2007.

-. *Washington Post*. 19 Shkurt 2006. <http://www.washingtonpost.com/wp-dyn/content/article/2006/02/17/AR2006021702499.html> (vizituar më 20 Janar, 2015).

Russ-Mohl, Stephan. *Gazetaria*. Tiranë: K&B, 2010.

Shkullaku, Armand. «Karakteristikat e menaxhimit redaksional në Shqipëri dhe Kosovë.» Në *Media në demokratizim*, nga Grup autorësh,

180-184. Tiranë: Papirus, Fondacioni Konrad Adenauer, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit – Universiteti i Tiranës, 2015.

Sturges, Paul. a.d.  
<http://www.ifla.org/files/assets/faife/publications/sturges/self-censorship.pdf> (vizituar më 04 Janar, 2015).

Terje S. Skjerdal; *Justifying Self-censorship: A Perspective from Ethiopia; Westminster Papers in Communication and Culture* © 2010 (University of Westminster, London), Vol. 7(2): 98-121.

UGSH. *Deklaratë e Unionit të Gazetarëve Shqiptarë*. Tiranë. 21 Shtator 2013.

UGSH. *Praktikat e punës informale në median shqiptare*. Vjetor, Tiranë: Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, 2012.

White, Aidan. *Ethical Journalism Network*. a.d.  
<http://ethicaljournalismnetwork.org/en/contents/fear-in-the-nees-the-difference-between-self-censorship-and-ethical-journalism> (vizituar më 12.02. 2015).

Wilhelm, Patricia. «Mbrotja e burimeve të informacionit. Media: Rrugët drejt lirisë.» Në *Diskutim për etikën*, nga ISHM, 147-152. Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias (ISHM), 2007.

Yeşil, Murat. «The Invisible Threat for the Future of Journalism: Self-Censorship and Conflicting Interests in an Increasingly Competitive Media Environment.» *International Journal of Business and Social Science*, March 2014: 71-78.